


BIBLIOTEKA E
8JA-1
E. 56
SHITITI
GJIROKASTËR

MEHMET ELEZI

ZHURMOJNE UJVARAT

VJERSHA



85H-1

E.56

MEHMET ELEZI

S

ZHURMOJNË UJVARAT...

(Vjersha)

~~53801~~

SHKURTËRA E SHITUR
KALIMZAS FIE

12 190

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

MIRUPAFSHIM, NANË!

Agimi i freskët,
si nuse malësore,
kreshtave po u fshin të natës pluhun.
Sonte, nanë e dashun,
fjete veç pak orë:
për aksion po nisem dhe unë.

N'heshtje nata shkrihej
(këndonte veç centrali)
E n'kaltërsinë e thellë dridheshin yjet.
Ti akoma s'flije:
dhe një mollë ma tepër
fshehtas meje në valixhe shtije.

Tash po nisem...
Gëzimi që djali
t'u ba me përcjellë, me vesë sytë t'i ngjeu.
Po dhe m'i ngul sytë dridhshëm;

shqetësohesh prej syzezës
që gërshetin gështenjë e preu?

Mirupafshim!
Kur mbi Myzeqe,
si një liqen i kaltër nata do të derdhet,
mes shokëve, dashunive,
me kangë në buzë e në shpirt,
yt bir aq i lumtun trasesë do të kthehet.

Ndërsa ti do të zbresësh tek ahu i vjetër
me enën e drujtë nën burim.
Si krah shqipeje
shaminë ta merr era,
ndërsa thinjat
kunorë të rrinë.

Dhe ashtu do t'shohësh
në shtegun me pisha,
ku po derdhem unë si parëverë.
Krenari e ashpër
muzgut do të t'ndrisë:
kështu shumë përcolle e prite shumë herë.

Dhe kështu dhe mue
sa herë do m'përcjellësh

si këtij shtegu me pisha
në këtë agim.

Nëse Atdheu i ri të dyve na thërret,
ena e drunjtë
nën shkumë
do të thinjet, nën burim.

1968

TREGIM PËR MËSUESEN

Ajo zbriti
si drenushë prej malesh,
tue shkelë të lashtin kanun.
Tue shkelun përmbi grumbuj fjalësh,
që zvarriteshin
tinëz nëpër katund.

Ajo zbriti...
Hoqi shaminë e kokës
dhe ashtu ballënaltë,
ndanë kullës majë kodrës,
zbriti në udhë, kur vjollca nën gardh sa
kish mbi.

Ajo zbriti prej fshati me pisha,
tue shkelë e heshtun livadhe t'blerta,
ku sa herë

dhentë ja trembi bisha,
tok me andrat
si flutura të lehta.

Ajo zbriti,
donte të merrte dritë,
donte dritë të derdhte në fshat.

Ndaj atë mbrëmje vonë,
diku u ndigjuen mbytn
dy opinga të trasha
në asfalt.

Dhe u kthye
mësuese e re,
e qetë — sikur sillte tufën pyllit me lajthi.

Ndërsa i jati,
që pati mbushë koburen,
kryet e thinjun uli:
«Mirëseardhe, bijë!»

1967.

DRITË E RE NDËR MALE

Nji krismë sëpate ndigjohej mëngjezeve të kristaltë
dhe humbiste thellë, n'pishnajën ngarkue me borë.
Akoma pa zbardhë,
dilte malësori prej kullës së lashtë
për pak dritë,
për pak zjarr,
për pak pishë të thatë,
për kalamajt' e unshëm dhe të ngratë,
tue ça të ftohtë borë me gjoks malësori,
kur ende si agim mbi bjeshkë nuk qe shpalosë
Nandori.

Poshtë Valbona rridhte e kaltër, plot valë, plot
shkumë,
Vraponte, dredhonte, përplasej nëpër shkrepë.
Spërkatte brigjet — akull.
Dhe kanga e saj pa fund
i përshkonte thellë lugjet që ka bjeshka.

Kështu dimnit të ashpër...

Dhe, kur pranvera

malet veshë n'alabastër niste me i hukatë,

përsëri grykës së përronit tretej një krismë e thatë,

përsëri Valbona rridhte ashtu plot shkumë,

me ujnat breg më breg.

Me gjoksin dallgëzor përfshinte lisa të shkulun,

që i mbërtheheshin në çdo shkrep,

që s'mund t'ja ndalnin udhën.

Po ç'ka sot që nxiton plot gëzim postjeri

dhe një gazetë të thjeshtë si flamur e ngren lart?

Ndërsa grykave si thikë të pret veri,

ndërsa kreshtave bora po fijat?

Ç'janë këto shkronja të zakonshme, të zeza,

që pishën e tymosun po e përzanë nga çdo kullë?

Ç'janë këto shkronja të vogla

e të mëdha si shkrepa,

që po i ndalin Valbonës të pandalshmin vrull,

që përziejnë tinguj radioje dhe kangë lahute?

— Fjala e Partisë!

Ndaj ndalni

ujna mali,

që ndër shekuj shungullet nëpër shkrepa!

Duem ne mbij ju

t'shungullojë centrali

e të përcjellë kangët mes pishave të blerta.

Ku gjëmonte ortiqet netëve dimnore,

ku vrapon flladi përmes barit,
ku ndihet kangë e re e muzës së lashtë malësore,
shpërthye prej gëzimit të çobanit.
Se dhe atje, ku gëzimi shetiste veç ndër përralla,
se dhe n'Bjeshkët e Namuna
dritë e re do të dalë.

1967.